

“Stela 2000” Sh.p.k.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

(te Ushtrimit te mbyllur me date 31.12. 2019)

20 Prill 2020

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ste-la 2000” sh.p.k.

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

1. Informacion i përgjithshëm.

Shoqëria “Stela 2000” shpk është themeluar me vendim te Gjykates nr.23716, dt 05.05.2000 me ortake:

- Z. Gjergji Stefanidhi me 50% te pjesmarrjes ne kapital te barabarte me 2.057.000 leke,
- Z. Fejzi Lamaj me 50% te pjesmarrjes ne kapital te barabarte me 2.057.000 leke.

Shoqeria eshte e rregjistruar ne Drejtorine Rajonale Tatimore Fier me nipt K12518401O. Veprimtaria e shoqerise rregullohet sipas dispozitave te Ligjit Nr.9901, dt.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, nga statuti dhe Legjislacioni ne fuqi.

Selia e shoqerise eshte ne Lagjen: 8 Shkurti, Fier.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise “Stela 2000” shpk eshte: “Projektim, ndertim objekte te ndryshme, rikonstruksione, prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit”.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi


Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ste-la 2000” sh.p.k.

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahaseshmëria e informacionit kontabël


Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

1. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

1.1 Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ste-la 2000” sh.p.k.

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82

1.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- **Mjetet monetare**

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.


- **Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- **Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- **Hua të marra dhe të dhëna**



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ste-la 2000” sh.p.k.

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

1.3 Inventarët


Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

1.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ste-la 2000” sh.p.k.

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:


Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri e pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlere e mbetur	20%
Paj, zyre e informat	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

1.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ste-la 2000” sh.p.k.

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

1.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

1.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

1.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

1.9 Tatimi mbi fitimin


Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 8.2% (2018: 14.5%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ste-la 2000” sh.p.k.

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Aktivitetet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

1.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

1.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

1.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

1.13 Aktivitetet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Postet e bilancit paraqiten:

Aktive monetare per 12.146.343 leke paraqesin mjete monetare ne banke.

Shoqeria operon me disa banka, te gjitha veprimet jane rregjistruar ne ditaret perkates, me llogarite ne valute veprimet jane kryer me kursin ditor, ndersa gjendja e monedhave te huaja ne fund te ushtrimit eshte vleresuar me kursin e Bankes se Shqiperise me date 31 dhjetor 2019, duke kaluar sipas rastit ne llogarite e shpenzimeve apo te ardhurave diferencat e kembimit.

Te drejta te arketueshme ne vleren 27.881.292 leke detajohen si me poshte:

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ste-la 2000” sh.p.k.

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Nga aktiviteti i shfrytezimit ne vlere 9.046.105 leke paraqet llogarine Kliente per vleren e faturave te paarketuara. Kjo llogari eshte e analizuar sipas klienteve dhe rakordon me llogarine sintetike te tyre.

Te tjera te drejta per 18.835.187 leke paraqet:

- **Tatim fitimi** ne shumen 301.384 leke,
- **Tvsh** ne shumen 264.694 leke,
- **Te tjera te drejta** ne shumen 18.269.109 leke paraqet detyrim te te treteve ndaj shoqerise.

Aktive afatgjata materiale

Shoqeria ka nje vlere neto aktivesh afatgjata materiale per 5.714.796 leke e cila perbehet si me poshte

	Viti 2019	Viti 2018
Makineri dhe Pajisje pune	4.052.396	5.065.496
Mjete Transporti	1.447.592	1.809.490
Pajisje Zyre e informatike	214.808	268.510
Totali	5.714.796	7.143.496

Aam jane pakesuar me amortizimin e llogaritur ne shumen 1.428.700 leke e cila nuk kalon kufijte fiskal. Aam justifikohen me inventar fizik te kryer ne fund te ushtrimit.

DETYRIMET DHE KAPITALI

Kapitalet e veta paraqiten me vlere 36.041.531 leke.

Kapitali i nenshkruar i shoqerise eshte 4.114.000 leke, ai perputhet me kapitalin e regjistruar ne regjistrin tregtar.

Rezerva ligjore 1.681.827 leke, e pandryshuar nga viti kaluar.

Rezerva te tjera per 23.942.174 leke, e pandryshuar nga viti kaluar.

Fitimi i ushtrimit 2018 ne shumen 10.319.778 leke eshte shperndare si dividend sipas vendimit te asamblese mbi miratimin e pasqyrave financiare 2018.

Fitimi i ushtrimit sipas bilancit kontabel paraqitet per 6.303.530 leke.

Detyrimet afatshkurtra

Detyrimet me vlere 9.700.900 leke perfagesojne:

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE**"Ste-la 2000" sh.p.k.****(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)**

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	449.567	
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore	9.231.833	6.428.987
Detyrime tatimore	19.500	1.361.872
Te tjera		
Totali	9.700.900	7.790.859

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit per 449.567 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara.

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore paraqitet detyrimi i shoqerise per pagat e punonjesve ne shumen 8.994.126 leke dhe detyrim ndaj sigurimeve per muajin dhjetor 2019 ne shumen 237.707 leke.

Detyrimet tatimore paraqesin: Tatim mbi te ardhurat per 19.500 leke, detyrim per muajin dhjetor 2019.

Verifikimi i llogarise Fitim Humbje

Shpenzimet dhe te ardhurat jane grupuar si me poshte:

	Viti 2019	Viti 2018
Te ardhura		
Nga shitja e produkteve	91.155.211	86.419.601
Totali (Afarizmi)	91.155.211	86.419.601
Shpenzime te veprimtarise		
Materiale te konsumuara	60.417.611	40.058.713
Kosto e punes	11.714.570	10.578.465
Pagat e personelit	10.038.192	9.061.455
Shpenzimet per sigurime	1.676.378	1.517.010
Amortizimi	1.428.700	1.740.395
Shpenzime te tjera	10.043.626	22.975.117
Totali i shpenzimeve	83.604.507	75.352.690
Interesa te fituara	455	1.443
Diferenca kursi kembimit	(83.165)	(117.530)
Te ardhura te zyra e punes		1.190.091
Fitimi Bruto	7.467.994	12.140.915
Tatim fitimi	1.164.464	1.821.137
Fitimi Neto (bilanci)	6.303.530	10.319.778

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ste-la 2000” sh.p.k.

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Shpenzimet jane 83.687.672 leke ndersa te ardhurat 91.155.666 leke. Rezultati ushtrimor neto qe shoqeria ka realizuar nga veprimtaria e saj eshte fitim 6.303.530 leke.

Faturat tatimore jane regjistruar dhe kontabilizuar korrekt ne llogarite perkatese. Ne te ardhurat e shoqerise jane perfshire dhe te ardhura nga interesat ne shumen 455 leke.

Shpenzimet jane 83.687.672 leke, ato justifikohen me dokumenta te rregullta fiskale. Me konkretisht shpenzimet sipas zerave jane:

Shpenzimet per materiale ne shumen 60.417.611 leke, jane perdorur per veprimtarine kryesore te shoqerise, keto shpenzime jane te justifikuara me dokumenta.

Personeli, ne kete llogari jane pasqyruar shpenzimet per paga 10.038.192 leke, sigurime shoqerore 1.676.378 leke, listepagesat jane perpiluar sakte dhe shpenzimet per paga e sigurime jane vendosur korrekt ne kete llogari. Nje permbljedhese e tyre paraqitet :


muajt	paga	paga	punedhesi	punemarras i	sig shend	totali	nr	tatim page
janar	942,000	942,000	141,300	89,490	32,028	268,018	35	5,200
shkurt	896,000	896,000	134,000	85,120	30,464	254,784	37	5,200
mars	999,000	999,000	149,850	94,905	33,966	294,971	33	16,250
prill	850,000	850,000	127,500	80,750	28,900	253,400	31	16,250
maj	757,000	757,000	113,550	71,915	25,738	227,453	26	16,250
qershor	741,000	741,000	111,150	70,395	25,194	222,989	22	16,250
korrik	741,000	741,000	111,150	70,395	25,194	222,989	22	16,250
gusht	741,000	741,000	111,150	70,395	25,194	222,989	22	16,250
shtator	741,000	741,000	111,150	70,395	25,194	222,989	22	16,250
tetor	881,000	881,000	132,150	83,695	29,954	264,649	32	18,850
nentor	897,192	897,192	134,579	85,233	30,505	269,817	35	19,500
dhjetor	852,000	852,000	127,800	80,940	28,968	257,208	27	19,500
totali	10,038,192	10,038,192	1,505,329	953,628	341,299	2,982,256	29	182,000

Amortizimi ne shumen 1.428.700 leke nuk kalon kufijte fiskal.

Shpenzime te tjera per 10.043.626 leke paraqesin: shpenzime per transport dhe karburant 4.345.277 leke, shpenzime komisione banke per 183.532 leke, shpenzime taksa 147.368 leke, shpenzime poste telekom 45.396 leke, shpenzime mirembajtje 401.490 leke, te tjera 210.167 leke, shpenzime udhetimi e djeta ne shumen 4.350.600 leke, shpenzime siguracioni 64.700 leke, shpenzime gjoba 295.096 leke.

Shpenzime financiare diferenca negative kembimi ne shumen 83.165 leke.

Rezultati ushtrimor neto qe shoqeria ka realizuar nga veprimtaria e saj eshte fitim 6.303.530 leke.


Gjeshtje gjyqesore

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ste-la 2000” sh.p.k.

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi supozimin e biznesit në vijimësi, dhe drejtimi mendon se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

Administrator

Gjergji Stefanidhi

